

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	BIRN: Akuzat ndaj shefes së SHISH vënë në pikëpyetje sigurinë kombëtare të Shqipërisë
ADRESA	https://lapsi.al/birn-akuzat-ndaj-shefes-se-shish-vene-ne-pikepyetje-sigurine-kombetare-te-shqiperise-i1094327
BURIMI	lapsi.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 19:36:56 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	23 shtator 2026, 19:32:40 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	5b6d32ae49b764944e3dc6b25786010147215a0cc4f715133aba88e58efbb596
TEKSTI	ff3b015ea16ec308fd5d18a7ae8bce1540c01ff134598280ed47ba20c2eff0f1
PAMJA	f595b8e2df3402266b8243de9def279cad8384288bbd576b83527194e6b65da6

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	c0d5b4b532dbce13fae6ea7c1eaa05b02ee3394848b0299e5e120f187130c335
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/c0d5b4b532dbce13fae6ea7c1eaa05b02ee3394848b0299e5e120f187130c335>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

BIRN: Akuzat ndaj shesës së SHISH vënë në pikëpyetje sigurinë kombëtare të Shqipërisë

Akuzat e ngritura ndaj Vlora Hysenit për nxjerrje të sekretit shtetëror dhe përkrahjes së autorit të krimit kanë dëmtuar, sipas ekspertëve të sigurisë, edhe reputacionin e Shërbimit Informativ të Shtetit, i cili kërkon vite punë për t'u rikuperuar.

LAPS.AL • 23 SEPTEMBER 2026



Në faqen zyrtare të Shërbimit Informativ të Shtetit, institucionit kyç të arkitekturës së sigurisë kombëtare, një slogan dallon mbi të tjerët: "Për ne Atdheu është i pari. Ne punojmë çdo ditë për ta bërë Shqipërinë më të sigurt".

Por një hetim i Prokurorisë së Posaçme ndaj drejtueses së këtij institucioni, Vlora Hyseni, e ka vënë seriozisht në pikëpyetje këtë mision.

Mëngjesin e së martës, Gjykata e Posaçme vendosi të pezullojë nga detyra Hysenin dhe ta vendosë atë në masën e sigurisë "arrest shtëpie", pasi akuzohet për veprat penale të nxjerrjes së sekretit shtetëror dhe përkrahjes së autorit të krimit si pjesë e një hetimi që lidhet me Ergys Agasin, një personazh kontrovers i arrestuar për krijimin e një grupi të strukturuar kriminal me qëllim manipulimin e tenderave të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit.

Për të njëjtin hetim, gjykata miratoi kontrollin e banesës e banesës dhe atë personal të ish-kreut të Policisë së Shtetit, Ilir Proda si dhe arrestimin e një zyrtari të Institutit të Policisë Shkencore dhe të një personi të dytë, të cilët akuzohen respektivisht për nxjerrje të sekretit shtetëror dhe përkrahje të autorit të krimit.

Akuzat e ngritura nga SPAK në adresë të shesës së shërbimit sekret rikthejnë në vëmendje mënyrën se si ajo u përzgjedh për të drejtuar SHISH, ndërkohë që vënë në pikëpyetje integritetin e këtij institucioni si dhe sigurinë kombëtare të vendit.

E lindur në Kosovë në vitin 1984, Hyseni mbajti poste drejtuese mes viteve 2019-2021

ide



Rënia e Vlorës në shtratin e krimit
Armand Shkullaku



Haga, si përfundim i një epoke të gjatë yes-manizmi
Andi Bushati

MOTITRANA

15°C

KËMBIMIEURO

91.46

aktuale

28:33

Protestuesit kërkojnë "kokën" e Ramës: Krejt ekipi në pranga, s'të shpëton dot as banda

08:28



Afro katër muaj në shesh, qytetarët nuk tërhiqen: Kërkojnë largimin e Ramës



TIA dhe Vodafone sjellin teknologjinë Airbus në Tiranë

Ndiqe Lapsin edhe në



Me interes nga publiku



ne Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, AKI, kur ajo u shkaktoi në mënyrë të papritur nga kryeministri Albin Kurti dhe presidentja Vjosa Osmani.

Vetëm pak muaj pas largimit nga AKI, Hyseni u shfaq në Tiranë si këshilltare për sigurinë e kryeministrit Edi Rama. Për rreth një vit e gjysmë ajo qëndroi larg vëmendjes publike, por më 17 mars 2023 Rama njoftoi se e kishte zgjedhur atë si drejtuesen e re të SHISH, bashkë me një deklaratë të fortë mbështetjeje personale. Emërimi i saj u dekretua nga presidenti Bajram Begaj në prill 2023.

Për Ilir Kullën, ish-këshilltar i lartë shtetëror dhe ekspert i sigurisë, problemi nis me emërimin e Hysenit në krye të një institucioni kushtetues kaq të rëndësishëm.

“Thjesht zonja në fjalë e kishte një mision të pamundur atë detyrë që i dhanë,” tha Kulla duke iu referuar edhe përshkrimit të një ish-kolegu të Hysenit në AKI.

Kulla nuk e komentoi akuzën, pasi tha se nuk ishte njohur me faktet penale.

“...Por një gjë e kam shumë të qartë se, përgjimet e gjetur në zyrën e Ergys Agasit janë një litar i lënë varur për shumëkënd në Shqipëri,” theksoi ai.

Pas operacionit të zhvilluar nga SPAK, deputetë të opozitës kërkuan që ngjarja të trajtohej si çështje e cënimit të sigurisë kombëtare dhe të futej në rendin e ditës së Kuvendit të Shqipërisë. Opozita e konsideroi këtë ngjarje si “rënie të shtetit dhe të sigurisë kombëtare”, ndërkohë që deputetët e mazhorancës e relativizuan skandalin tek përgjegjësia individuale e zyrtarës së lartë.


Arjan Dyrmishi, drejtor ekzekutiv i Qendrës për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes, vlerëson se akuzat e ngritura ndaj Hysenit kanë shkaktuar sakaq një dëm të madh për reputacionin dhe integritetin e Shërbimit Informativ të Shtetit, të cilat kërkojnë vite dhe shumë punë për t’u rikuperuar.

Sipas tij, kur njerëz me këtë lloj integriteti drejtojnë institucione të rëndësishme si SHISH, nuk mund të dihet se me kë i ndajnë të dhënat. Dyrmishi vlerëson se dëmi jep pasoja dhe në një plan më të gjerë, nisur nga fakti se Shqipëria është një vend anëtar i NATO-s.

“Për momentin mund të themi se ka dëme në cënimin e integritetit dhe reputacionit të institucioneve në fjalë, si dhe të dëmtimit të besimit dhe bashkëpunimit mes institucioneve,” tha ai.

Dyrmishi vlerëson gjithashtu se dëmi i reputacionit është pjesë e cënimit të sigurisë kombëtare, e cila do të duhej të garantohej sipas tij nga arkitektura e brendshme e gjithë institucioneve.

“Se si do të përshkallëzohet dëmi mbetet për t’u parë,” theksoi Dyrmishi për BIRN. /Marrë nga **Reporter.al**



Video që tregon se Rama e dinte paraprakisht për Vlora Hysenin



Përgjimet ekskluzive/ “O shpirt”, “o zemër”. Vlora, një spiune që pasioni e çoi drejt krimit



Bomba tjetër për qeverinë Rama/ Prova e fakte se ku shkojnë paratë e zhvatura nga korrupsioni



Arrestohet në Morinë shefja e SHISH, Vlora Hyseni

Të këshilluara



I dyshuar për trafikun e 50 tonëve kokainë, arrestohet në Rusi Salvatore (Shpëtim) Aliu

Salvatore alias Shpëtim Aliu, i shpallur në kërkim nga drejtësia shqiptare dhe i konsideruar nga SPAK si një prej figurave kyç...



Dokumentari austriak për korrupsionin në Shqipëri/ Gazetarja jep detaje: Po kontrollohen faktet

Gazetarja investigative Lindita Çela ka zbuluar detaje nga dokumentari austriak që po përgatitet për korrupsionin në Shqipëri. ...



Dash Shehi: Rama emëroi Vlorë Hysenin në krye të SHISH për t'i bërë karshillëk Albin Kurtit



Protestuesit kërkojnë "kokën" e Ramës: Krejt ekipi në pranga, s'të shpëton dot as banda

Qytetarët kanë vijuar këtë të mërkurë për të 116-tën ditë radhazi protestën kundër qeverisë...



Komisioni Evropian konfirmon dhjetorin 2027 për mbylljen e negociatave me Shqipërinë

Në një zhvillim të rëndësishëm për aspiratat evropiane të Shqipërisë, Komisioni Evropian është shprehur i gatshëm të mbështesë objektivin e vendosur për vitin 2027 si afat të mundshëm për anëtarësimin e plotë të vendit në Bashkimin Evropian, duke shënuar një moment kyç në rrugëtimin e saj drejt BE-së.



Berisha: Vlorë Hyseni i ka dhënë krimit sekretet shtetërore

Sali Berisha, në mbledhjen e Kryesisë dhe Sekretariateve të PD-së, foli lidhur me skandalin e SHISH, për të cilin tha se “e...



Afera e SHISH, Berisha përjashton bojkotin e Parlamentit: Rama më i damkosur se kurrë



Zjarr në Parkun e Viroit në Gjirokastrë

Një zjarr i përmasave të konsiderueshme ka rënë pasditen e sotme në dalje të Liqenit të Viroit në Gjirokastrë...



Familjet Thaçi, Veseli e Krasniqi kërkojnë përgjegjësi institucionale: Presim të takohemi pas vendimit të Kuvendit

Familjet e Hashim Thaçit, Kadri Veselit dhe Jakup Krasniqit kanë bërë thirrje për përgjegjësi institucionale dhe unitet qy...



Kadastri derë më derë në Himarë, evidentohen 235 banesa me probleme pronësie, procesi vijon deri në fund të nëntorit

Agjencia Shtetërore e Kadastrës vijon punën në terren për evidentimin dhe trajtimin e banesave pa dokumentacion pronësie, nga sht...

Me sytë katër



21:28

PAMJET/ Rrëzohet gjatë stërvitjes në Uells avioni ushtarak britanik

Dy pilotë të Forcave Ajrore Mbretërore Britanike (RAF) u nxorën nga avioni i tyre i stërvitjes përpara se ai të rrëzohet...



"E ke dëgjuar atë këngën Zegjine, Zegjine..." / Aktivistja i zë pritë deputetes së PS

21:17



PAMJET/ 6-vjeçarja kineze vë rekord botëror për zgjidhjen e Kubit të Rubikut

21:27



PAMJET/ Nis papritur bora në bjeshkët e Deçanit

20:52



Dy VIDEO-t/ Si e paralajmëroi Gaz Bardhi lidhjen Gys Agasi-Vlora Hyseni

16:12

SPORT

→ Të tjerë artikuj



Klopp i ndalon lojtarëve të Gjermanisë parukierin: rregulla strikte për kombëtaren e tij



Përplasje verbale mes Van Dijk dhe një gazetari në sallën e konferencës: "Kenë përhapur marrëzira"



"Jam futbollisti më i bukur në botë": moda, aludimet dhe raporti i Maduka Okoye me Belen



15:23

Sulmi kuqezi kundër teknikut Sylvinho, Daku e Seferi kunja brazilianit: "Tani e ndejmë rëndësinë"



12:43

Kush është Younes Ebnoutalib, i thirrur nga Klopp te Gjermania me një përvojë te Perugia në Serie C: "Më trajtuan si qen"



12:17

Serie A, parashikimet e Superkompjuterit: Interi kampion, Milan dhe Napoli jashtë Champions



11:51

E bujshme te Napoli: "Allegri drejt dorëheqjes!". Ja si qendron situata

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.